



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

I nderuar ministër Nuredini,

Në zgjedhjet parlamentare që janë mbajtur më 15 korrik të vitit 2020, qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë zgjedhur që të vazhdojmë ta dërgojmë shtetin përpara. Vota e qytetarëve për koalicionin që ka formuar Qeverinë e re me mandat prej vitit 2020 deri në vitin 2024 është investimi i tyre vetanak në kërkim të jetës më të mirë për vete, për familjet dhe bashkësinë e tyre. Vota e secilit qytetar është votë për mbrojtje nga KOVID-19 dhe për menaxhim të suksesshëm me krizën ekonomike-shëndetësore, votë për ekonominë e re vendore, për vende të reja të punës të paguara mirë, për shtet të së drejtës, për mjedis jetësor të pastër dhe të shëndetshëm, për infrastrukturë funksionale, për lidhje efektive mbrenda vendit dhe me botën, për kulturë të fuqishme nacionale sipas modelit evropian dhe arsim që i përgatit gjeneratat e reja për të tashmen dhe një të ardhme më të mirë.

Në kuptimin burimor të fjalës „ministër“ gjendet shërbimi, kujdesi dhe ndihma për qytetarët. Ju, si ministër, duhet ta kuptoni votën e qytetarit si drejtim i precizuar që vjen nga niveli më i lartë nga i cili nuk ka asnjë devijim. Duhet t'u shërbeni të gjithë qytetarëve, pa dallim të përkatësisë së tyre etnike, partiake, orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor, racor, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, përkatësisë në grupe të marginalizuara, gjuhës, statusit social, shkollimit, religjionit, bindjet politike, bindjet tjera, aftësive të kufizuara, moshës, statusit familjar apo martesor, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, statusit personal dhe statusit shoqëror. Pres që për kryerjen e detyrave tuaja dhe në realizimin e Programit për punë të Qeverisë për vitet 2020-2024, do të angazhoheni pa hezitim dhe me profesionalizëm. Kemi detyrim të shenjtë dhe thelbësor që axhendën për të cilën obligohemi para qytetarëve ta realizojmë duke investuar përpjekjet tona maksimale, përmes realizimit efektiv për arritje të rezultateve më të mira të mundshme. Kjo mënyrë nuk njeh kompromise, justifikime dhe përfshin ekspozim të vazhdueshëm para opinionit publik ku do t'i vëmë në dispozicion të gjithë mekanizmat për të ndjekur punën tonë.

Ju jeni pjesë e Qeverisë e cila hapur e prezanton punën e saj dhe është e hapur për secilin qytetar të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Unë, si Kryetar i Qeverisë do ta avancoj strukturën e kabinetit tim me qëllim që të jem Kryeministër më i hapur dhe të siguroj komunikim të dyanshëm me të gjithë qytetarët dhe bashkësitë të cilëve ju duhet ndihmë nga unë dhe shërbimet e mia, por edhe të kem mundësi që t'i pranoj dhe t'i kuptoj të gjitha idetë dhe iniciativat që vijnë nga opinioni publik.

Ju obligoj edhe juve për komunikim të rregullt dhe të hapur me të gjithë qytetarët dhe palët e interesit në shoqëri duke avancuar kanalet për përgjegjshmëri, gjithëpërfshirje dhe pjesëmarrje.

Puna juaj çdo ditë ndiqet dhe matet. Nëse jeni të përkushtuar, të ndershëm dhe të përgjegjshëm do të keni rezultate të shkëlqyeshme dhe do të vazhdoni të punoni edhe më mirë për më shumë rezultate. Në të kundërtën, do të zëvendësoheni me kuadër tjetër i cili është i gatshëm të jep angazhim më të mirë dhe më të sigurtë se sa Ju. Vetëm kështu është e drejtë dhe e ndershme para fjalës që ua kemi dhënë



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

qytetarëve. Për atë, konkluzionet e para nga puna juaj do t'i sjell pas përfundimit të 100 ditëve të para të mandatit, gjegjësisht në përfundim të vitit 2020, pas të cilit janë të mundshme ndryshime kadrovike. Analizën metodologjike të realizimit të detyrave dhe punës suaj të përgjithshme do ta bëjmë në çdo fundvit.

Duke ju nominuar juve për ministër në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, isha i bindur se mund të llogaris në përgjegjësinë dhe përkushtimin tuaj të plotë në kryerjen e detyrave. Pikërisht për këtë, pres rezultate të menjëhershme. Qytetarët kanë pritje, ndërsa Ju jeni në pozicion që të bëni gjithçka që është e nevojshme që Qeveria të realizojë pritjet e qytetarëve.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut u përcaktua të ndjekë strategjitë dhe planet e reja për ripërtëritjen e komponentës ekonomike, sociale dhe ekologjike të Bashkimit Evropian në luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe zhdukjes së biodiversitetit, veçanërisht përmes zbatimit të Marrëveshjes së gjelbër të Bashkimit Evropian dhe Synimeve për zhvillim të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Para jush është mandati i ri për të udhëhequr një nga resorët kyç, për të cilin kemi vendosur disa nga qëllimet më të rëndësishme të kësaj Qeverie: mjedis i pastër, i shëndetshëm dhe i ruajtur mirë si mbështetje e një ekonomie të qëndrueshme dhe shoqëri ku jetojnë qytetarë të kënaqur.

Në këtë mandat, pres që puna juaj të udhëhiqet në bazë të disa parimeve themelore: luftë kundër ndryshimeve klimatike në nivel botëror, si pjesë integrale e të gjitha politikave sektoriale, veprim parandalues, ndotësi paguan, luftë kundër ndotjes së mjedisit duke filluar nga burimi i ndotjes dhe integrimi i mbrojtjes së mjedisit jetësor në politikat tjera.

Në katër vitet e ardhshme, përmes planifikimit inteligjent dhe udhëheqjes së proceseve, pres nga ju:

- Të punoni intensivisht në zgjidhjen e problemit me ndotjen e ajrit, si dhe të siguronit sistem modern për monitorimin e cilësisë së ajrit:
 - o Deri në vitin 2024, asnjë institucion shtetëror të mos ngrohet me sisteme të vjetra dhe jo-ekologjike për ngrohje dhe të investohet në efikasitet energjetik të ndërtesave publike;
 - o Deri në fund të vitit 2020 të vendosni kontroll 24/7 të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe të inspektorateve lokale, ndërsa duke u rritur kapacitetet lokale të rriten kompetencat e tyre;
 - o Të propozoni dënime më të ashpra në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor;
 - o Në dy vitet e para të zbatoni gjelbërim intensiv të shtetit, veçanërisht në qytetet më të ndotura, në bazë të Planit për gjelbërim”;
 - o Në bashkëpunim me Drejtorinë për Punë Hidrometeorologjike, të vendosni sistem për paralajmërim të hershëm për motin që përmban shfaqjen e ndotjes së rritur të ajrit;



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

- o Në bashkëpunim me Qeverinë të investoni në stacione matëse shtesë në të gjithë vendin dhe në një aplikacion të veçantë softuerik që do të mundësojë shfaqje më të lehtë dhe më transparente të situatës me PM grimcat;
- o Të mbështetni Qytetin e Shkupit në ndërtimin e një sistemi të shpejtë për transport me tramvaj, dhe në bashkëpunim me pushtetet lokale dhe qytetarët të krijoni model ligjor dhe institucional për përmirësimin e trafikut për biçikleta;
- o Të propozoni ndryshime ligjore për zvogëlimin e vlerave të përcaktuara kufitare të substancave ndotëse të ajrit, dhe për rritjen e standardeve për cilësinë e karburanteve në drejtim të kontrollimit të më shumë parametrave;
- o Të përgatitni dhe të propozoni në Qeveri, Ligj për emetimet industriale dhe në bashkëpunim me institucionet kompetente të siguron linja të lehta kreditore për prokurimin e pajisjeve dhe teknologjive të reja për zvogëlimin e ndotjes së mjedisit për ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe të mëdha;
- Të përgatitni dhe të propozoni në Qeveri ligj me të cilin do të krijohet polici komunale në nivel lokal, me anë të së cilit inspektorët aktual komunal dhe eko-patrullat do të jenë në gjendje që së bashku të ndërmarrin masa për kryerësit e veprave të dëmshme;
- Të mundësoni kontroll të përforcuar të vendeve ku zhvillohet ndërtimtaria si dhe respektim dhe kontroll kritereve energjetike dhe kritereve tjera gjatë ndërtimit dhe rikonstruktimit të ndërtesave;
- Të ndërmerrni masa që do të kontribuojnë në përmbushjen e synimeve për reduktim dhe menaxhim të mbeturinave:
 - o Të përgatitni Plan kombëtar gjashtë-vjeçar për parandalimin e mbeturinave si qëllim nacional dhe politik për krijimin, zvogëlimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave;
 - o Në bashkëpunim me Qeverinë, të mundësoni që deri në fund të vitit 2025, të paktën 60% e peshës së mbeturinave të ambalazheve të krijuara në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut të ripërdoret ose të përdoret për të krijuar energji, ndërsa minimum 55% e peshës së mbeturinave të ambalazheve të krijuara dhe të mbledhura në territorin e vendit të riciklohet;
 - o Të arrini përparim në selektimin primar të llojeve të posaçme të mbeturinave;
 - o Të krijoni infrastrukturë të integruar rajonale për mbledhjen dhe trajtimin e mbeturinave, në mënyrë që zvogëlimi total i mbetjeve të tretshme të mbeturinave që deponohet në deponi për periudhën 2020-2026 të jetë 25%;
 - o Të vendosni kontrole të përforcuara të importit dhe eksportit të mbeturinave, grumbullimin, magazinimin dhe trajtimin e të gjitha llojeve të mbeturinave, si dhe kontroll të jashtëzakonshëm të të gjitha lejeve të lëshuara për menaxhimin e mbeturinave;



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

- o Të mundësoni kontrole të përforuara nga inspektorati ndaj personave juridik që kanë leje për mbledhje, transport dhe trajtim të mbeturinave;
- o Të zbatoni aktivitete për sistem të integruar dhe financiarisht të qëndrueshëm për menaxhimin rajonal të mbeturinave të ngurta në rajonin Lindor dhe Verilindor dhe të krijoni sistem për menaxhim dhe financim të sektorit për mbeturina komunale në rajonin Juglindor, të Vardarit, Jugperëndimor dhe të Pellagonisë:
- Të mbështetni autoritetet lokale në prokurimin e 10.000 koshave dhe kontejnerëve për mbeturina në vit;
- Të vendosni ndalesa graduale të përdorimit të qeseve plastike në pakicë;
- Të gjeni zgjidhje të rehabilitoni pikat e nxehta industriale;
- Në përputhje me riorganizimin e institucioneve, të rishikoni strukturën institucionale dhe ndarjen e kompetencave për monitorimin gjithëpërfshirës të gjendjes dhe cilësisë së ujit;
- Të ndërmerri masat e duhura për rehabilitimin e rrjeteve të kanalizimeve dhe stacioneve të filtrimit;
- Të rritni përqindjen e zonave të mbrojtura duke bërë valorizimin e zonave që duhet të jenë të mbrojtura dhe rivlerësim të zonave të mbrojtura;
 - o Mali Sharr të shndërrohet në park kombëtar;
 - o Të miratohen planet për menaxhim me parqet kombëtare të Pelisterit, Galiçicës dhe Mavrovës, si dhe planet për menaxhim me zonat e mbrojtura;
- Në bashkëpunim me institucionet relevante të zhvilloni Strategji kombëtare për zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat;
- Të përmirësoni planifikimin hapësinor duke përgatitur Plan të ri hapësinor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për 15 vitet e ardhshme; Metodologji të re për përgatitjen e planeve hapësinore; dhe Rregullore të re për standardet dhe normat për planifikimin urban, që do të mbrojnë tokat e parashikuara për parqe dhe gjelbërim të mbrojtur, si dhe zonat rekreative, dhe gjithashtu do të përforcojë rregulloret për përqindje minimale të gjelbërimit për banor në nivel të planit të përgjithshëm urbanistik;
- Të realizoni aktivitete të tjera në përputhje me zotimet dhe Programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut 2020 – 2024.

Njëkohësisht, si ministër për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, pres nga ju:

- Të jeni gardiani i parë i Kushtetutës dhe ligjeve dhe të siguroni që Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor të përmbush të gjitha detyrimet ligjore, që të gjithë bartësit e funksioneve publike dhe zyrtarët që punojnë nën juridiksionin tuaj të jenë njësoj të përgjegjshëm ndaj ligjit dhe Kushtetutës dhe se Kushtetuta dhe ligjet të zbatohen njëjtë për të gjithë;
- Të jeni shembull i qeverisjes së mirë dhe të siguroni që zyrtarët publik dhe zyrtarët që punojnë nën juridiksionin tuaj t'u përmbahen standardeve më të larta të qeverisjes së përgjegjshme dhe etike;



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- KRYEMINISTRI -

- Të siguroni që Ministria për Mjedis Jetësor dhe Planifikim Hapësinor të përgjigjet në kohë, në mënyrë të drejtë, efikase dhe efektive të zgjidh çështjet dhe procedurat e qytetarëve dhe personave juridik, duke justifikuar dhe fituar besimin e qytetarëve dhe të opinionit publik;
- Të vazhdoni zbatimin dhe përmirësimin e politikave të transparencës dhe llogaridhënies;
- Të jeni i hapur dhe gjithëpërfshirës ndaj qytetarëve, publikut profesional, shoqërisë civile dhe opozitës në krijimin dhe zbatimin e politikave publike në mënyrë që të siguroni politika cilësore të bazuara në prova dhe konsensus të shoqërisë;
- Të siguroni që burimet shtetërore të mos përdoren për qëllime partiake dhe zgjedhore dhe që zyrtarët administrativ dhe punonjësit e sektorit publik të mos jenë subjekt i ndikimit partiak;
- Të promovoni barazinë gjinore dhe përfaqësimin e drejtë dhe të keni parasysh karakterin multietnik të vendit.

Bashkëpunoni me të gjithë punonjësit dhe përdorni të gjitha potencialet e administratës publike. Në të gjitha veprimet tuaja, të jeni shembull për ata me të cilët punoni dhe për qytetarët për të cilët punoni. Respektoni Kodin etik për anëtarët e Qeverisë dhe mbajtësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria dhe promovoni vlerat etike. Në fund të mandatit tonë në vitin 2024, si rezultat i ndryshimeve pozitive që ne do të bëjmë, Maqedonia e Veriut të jetë vend ku qytetarët duan të jetojnë dhe të kontribuojnë në përmirësimin e saj të vazhdueshëm. Qytetarët e presin këtë nga ne.

Ju uroj fat, shëndet dhe mandat të suksesshëm.

Sinqerisht i juaji,
Zoran ZAEV

Ministër për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor në Republikën e Maqedonisë së Veriut
Naser NUREDINI